

DPK

03/4383/12

Nr.485/05-2012

20.12.13

**Gjykata Themelore-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni për Kundërvajtje në Prizren**, me gjyqtarin Alija Fazli, në procedurën e kundërvajtjes kundër të pandehurit Fatmir Kastrati nga Prizreni, për shkak të kundërvajtjes nga nen.5, 6 par.1.3 dhe nen.9, e dënueshme sipas nen.17 par.1.3 Ligjit mbi deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë zyrtarëve të lartë publik, dhe deklarata mbi prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për gjithë personat zyrtar (Z.04/L-050), e në bazë të nen.195 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më 29.11.2013, morri

## AKTVENDIM

**PEZULLOHET** procedura e kundërvajtjes kundër të pandehurit Fatmir Kastrati, nga babai Rexhep, i lindur më 05.03.1964 në Prizren, ku edhe tash jeton, në rr.Petro Marko, pn. për shkak kundërvajtjes nga nen.5, 6 par.1 dhe nen.9 e dënueshme sipas nen.17 par.1.3 të Ligjit mbi deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë zyrtarëve të lartë publik, dhe deklarata mbi prejardhjen dhe kontrollin për gjithë personat zyrtar (Z.04/L-050), sepse nuk ka prova se ka kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihet në barrë.

- Në bazë të nen.198 par.1 pik.8 Ligjit mbi kundërvajtjet,

Shpenzimet e procedurës bien në ngarkesë mjeteve të buxhetit të gjykatës,

- Në bazë të nen.110 par.2 Ligjit mbi kundërvajtjet

## Arsyetimi

Sipas kërkesë së Agjencisë kundër korrupsionit me seli në Prishtinë, nr.01-1900/2012, është inicuar procedura e kundërvajtjes kundër pandehurit Fatmir Kastrati nga Prizreni, për shkak të kundërvajtjes nga nen.5,6 par.1.3 dhe nen.9 e dënueshme sipas nen.17.par.1 të Ligjit mbi deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë zyrtarëve të lartë publik, dhe deklarata mbi prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për gjithë personat zyrtar (Z.04/L-050)

I pandehuri Fatmir Kastrati në deklaratën e tij ka theksuar që para skadimit të afatit dmth.15.03.2012 formularin e plotësuar – deklaratën mbi pasurinë ka dorëzuar eprorit të organit kompetent, dhe si provë kësaj gjykate paraqiti në shiqim kopjen e formularit të plotësuar mbi pasurinë për v.2012, sikur të ishte i befashuar pse është inicuar procedura e kundërvajtjes kundër tij.

Për vërtetimin e gjendjes së plotë faktike gjykata në cilësi të dëshmitarit dëgjoji Ibrahim Krasniqin, shërbëtor profesional për punët e Kuvendit pranë KK Prizren, dhe i njëjti deklaroi që Fatmir Kastrati formularin e plotësuar mbi pasurinë paraqiti më

15.03.2012, dhe si provë gjykatës paraiti listën me emrat e anëtarëve të Kuvendit të cilët në dorë dorëzuan formularët e plotësuar-deklaratat mbi pasurin, si dhe të njëjtat Agjencionit kundër korrupsionit në Prishtinë dërgoi më 06.07.2012, e si shkak i vonësës theksoi koordinimin e keqë ndërmjet zyrtarëve për kontakte pranë KK Prizren dhe Agjencionit kundër korrupsionit.

Me shiqimin në listën e paraqitur të anëtarëve të Kuvendit të Prizrenit të cilët dorëzuan formularët e plotësuar-deklaratat mbi pasurin për v.2012, nënshkruar nga ana e shefit të shërbimit profesional për çështje të Kuvendit të Prizrenit, Ibrahim Krasniqi, është vërtetuar që emëri i Fatmir Krasniqit gjendet në të njëjtën, si dhe ai formularin e plotësuar-deklaratën personit të përmendur, si eprorit në organin kompetent, dërgoi më 15.03.2012 dmth.pesëmbdhjet ditë para skadimit të afatit ligjor.

Duke vlerësuar deklaratën e pandehurit Fatmir Kastratit, deklaratën e dëshmitarit Ibrahim Krasniqi dhe me shiqimin në listën e anëtarëve të Kuvendit të Prizrenit, cilët në afatin ligjor formularët e plotësuar – deklaraten mbi pasurin dorëzuan para skadimit të afatit, është vërtetuar që i pandehuri Fatmir Kastrati nuk ka kryer kundërvajtje të cilit me kërkesë i vihet në barrë, sepse pas administrimit të gjitha provave në procedur u vërtetue që para skadimit të afatit ligjor formulari i plotësuar – deklaraten mbi pasurin eperorit ka dorëzuar në afatin ligjor, prandaj procedura e kundërvajtjes në bazë të nen.198 par.1 pik.8 të Ligjit mbi kundërvajtjet kundër tij PEZULLOHET.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në pajtim me nen.110 par.2 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

Nga gjitha të theksuarat është vendosur si në shqiptimin e aktvendimit.

**GJYKATA THEMELORE-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE**

**Nr.485/05-2012**

**Përkthyesi gjyqësor,**  
Kenan Hadri



**Gjyqtari,**  
Alija Fazlji, d.v.

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi mund të deponohet ankesa Gjykatës së Apelacionit-Departamenti i përgjithshëm-seksioni për kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditëve, nga dita e pranimit këtij aktvendimi. Ankesa parashtrohet përmes kësaj gjykate pa pagesë takse.